



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:236840

Datë: 14.12.2023

Numri i dokumentit: 05069033

**P.nr.775/21**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**  
Divizioni Penal, gjyqtarja e vetme gjykuese Ilda Cucović Sahatçiu, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Gylaj Nepola, në çështjen penale ndaj të pandehurit G. M.nga Peja,për shkak se ka kryer vepër penale „ Sulmi” nga neni 184 par.3 nën par.3.1 lidhur me par.1 të KPRK-së si dhe ndaj të pandehurit B.M.nga Peja , për shkak se ka kryer vepër penale „ Sulmi” nga neni 184 par.3 nën par.3.1 lidhur me par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm nën shenjën PP/IL.nr.1895/21 të dt.20.10.2021, pas mbajtjes së seancës të shqyrtimit fillestar me datë 15.11.2023, në praninë e Prokurorit të Shtetit të Prokurorisë Themelore në Pejë, Sadije Muriqi, të pandehurve G. dhe B.M.e në mungesë të dëmtuarit po të njëjtën ditë morri dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 14.12.2023, përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Të pandehurit:**

**1.G.M.nga** i ati B. dhe nëna F...e vajzërisë i lindur me ....., në Pejë me vendbanim në rr., G. D.” nr.89 Pejë, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor në firmën „ H.”, i martuar baba i .... fëmije, i gjendjes së mesme ekonomike, identifikohet sipas L. Njoftimit me nr. personal ..... të lëshuar nga MPB të R. Kosovës, posedon telefon me nr....., shqiptar, shtetas i R. Kosovës , gjendet në liri.

**2. B.M.,** nga i ati B. dhe nëna F. e vajzërisë i lindur me ....., në Pejë me vendbanim në rr., G. D.” nr.89 Pejë, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor në firmën „ H.”, i martuar baba i një fëmije, i gjendjes së mesme ekonomike, identifikohet sipas L. Njoftimit me nr. personal ..... të lëshuar nga MPB të R. Kosovës, posedon telefon me nr....., shqiptar, shtetas i R. Kosovës , gjendet në liri.

**JANË FAJTOR**

Sepse,

**I pandehuri G.M,**

Me datë. 22.06.2021, rreth orës 22:00 në rr., P.P. në Pejë, me dashje ka përdor forcën ndaj të dëmtuarit –të miturit E.K, në atë mënyrë që derisa i dëmtuari ishte duke e drejtuar automjetin kombi pronë e Kompanisë,, E’’ në të cilin punon i dëmtuari, në vendin e lartcekur ndalon kombin në kolon përball firmës,, H.’’, në ato momente i pandehuri i drejtohet me fjalët,, çka po shikon, ec mos më shiko’’ pastaj kur i dëmtuari arrin në vendin e punës së tij aty shkon i pandehuri ku fillimisht i drejtohet me fjalët,, ku je more mangup’’ e kap për fyti dhe bluzë dhe e shanë me nënë, e po ashtu tenton ta godas por ndërhyjnë disa punëtor dhe e ndalin,

- me çka ka kryer veprë penale „Sulmi’’ nga neni 184 par.3 nën par.3.1 lidhur me par.1 të KPRK-së.

**I pandehuri B.M.,**

Me datë. 24.06.2021, rreth orës 01:00 në rr., P.P. në Pejë, me dashje ka përdor forcën ndaj të dëmtuarit –të miturit E.K, në atë mënyrë që derisa i dëmtuari dhe kolegu i punës –dëshmitari L.J., ishin në kombi të firmës, i pandehuri i ofrohet dhe e godet shuplakë në anën e majtë të fytyrës të dëmtuarin,

- me çka ka kryer veprë penale „Sulmi’’ nga neni 184 par.3 nën par.3.1 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj, konform nenit 7, 38, 39, 40, 42, 43, 44, 69, 70, 71, nenit 184 par.3 nën par.3.1 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe nenit 364, 365, 452 par.1 të KPPRK-së, gjykata të pandehurit i :

**GJYKON**

**Ashtu që të pandehurit G.M i përcakton :**

**DËNIM ME GJOBË** në shumë prej 400.00 € (katërqind) euro, të cilën gjobë detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit

**Të pandehurit B.M.i përcakton :**

**DËNIM ME GJOBË** në shumë prej 400.00 € (katërqind) euro, të cilën gjobë detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse të pandehurit nuk dëshirojnë ose nuk mund të paguajnë gjobën, gjykata konform nenit 43 paragrafi 3 i KPRK-së mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim, ku 20 € (njëzet euro) gjobë llogaritet barabartë me 1 (një) ditë burgim.

Të pandehurit, secili veç e veç obligohen të paguajnë e shpenzimet e procedurës dhe atë paushallin gjyqësor në shumën prej 30 € (tridhjetë euro), në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Të pandehurit, secili veç e veç obligohen të paguajnë taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumë prej 20 € (njëzetë euro), në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Pala e dëmtuar E.K., me vendbanim në Pejë, rr. „M.B”, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzë nën shenjën PP/II. nr.1895/21 dt.20.10.2021, kundër të ndaj të pandehurit G.M nga Peja ,për shkak se ka kryer veprë penale „ Sulmi” nga neni 184 par.3 nën par.3.1 lidhur me par.1 të KPRK-së si dhe ndaj të pandehurit B.M. nga Peja , për shkak se ka kryer veprë penale „ Sulmi” nga neni 184 par.3 nën par.3.1 lidhur me par.1 të KPRK-së

Konform nenit 240 të KPRK-së, gjykata mbajti shqyrtimin fillestar me datë 16.11.2023, ku të pranishëm ishin Prokurori i Shtetit Sadije Muriqi, të pandehurit G.M dhe B.M .ndërsa mungonte i dëmtuari i mitur si dhe përfaqësuesi i tij edhe pse nga gjykata ishin njoftuar në mënyrë të rregullt për mbajtjen e seancës por mungesën nuk e kanë arsyetuar këtë fakt e vërteton edhe raporti i datës 14.11.2023.

Gjykata konform dispozitave të nenit 241 par.1 të KPRK-së, e ka udhëzuar të pandehurin në të drejtat e tij.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit te Shtetit , gjykata është bindur se të pandehurit e kanë kuptuar aktakuzën dhe duke vepruar në kuptim të nenit 242 par.4 të KPRK-se , të pandehurve iu është dhënë mundësia që të deklarohen për pranimin ose mospranimin e fajësisë.

I pandehuri G.M.i vetëdijshëm për rëndësinë dhe pasojat e pranimit të fajësisë deklaroi se vullnetarisht e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës,

I pandehuri B.M., gjithashtu i vetëdijshëm për rëndësinë dhe pasojat e pranimit të fajësisë deklaroi se vullnetarisht e pranon fajësinë për dy veprat penale të cilat i vihet në barrë sipas aktakuzës,

Prokurori i shtetit, lidhur me pranimin e fajësisë deklaroj se: pajtohem me deklaratën e të pandehurve mbi pranimin e fajësisë meqë të njëjtit ie kuptuan natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë.

Gjykata konform nenit 242 par.6 të KPPRK-së, pas dëgjimit të palëve të cilët u pajtuan me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, e ka miratuar pranimin e fajësisë pasi është bindur se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë konform dispozitave të nenit 242 par. 2, nën par. 2.1, 2.3, 2.4 të KPPRK-së, pasi që të pandehurit kuptuan natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza siç janë : Raporti fillestar i incidentit me nr.të rastit ..... i dt.24.06.2021, raporti i policit K.Z. i dt.24.06.2021,raporti i hetuesit A.S i dt.24.06.2021, deklarata e të dëmtuarit E.K e dhënë në Polici me datë 24.06.2021,deklarata e dëshmitarit L.J. e dhënë në Polici me datë 24.06.2021, deklarata e dëshmitarit E.F e dhënë në Polici me datë 12.09.2021,deklarata e të pandehurit G.M e dhënë në Polici me datë 04.09.2021, deklarata e të pandehurit B.M.e dhënë në Polici me datë 26.08.2021 si dhe shkresat tjera të lëndës.

Prokurori i shtetit, lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit i propozoi gjykatës që si rrethanë lehtësuese për të pandehurit te merret parasysh pranimi i fajësisë, faktin se të njëjtit asnjëherë më par nuk kanë ra ndesh me ligjin ,ndërsa si rrethanë rënduese te merret parasysh fakti se veprat penale të pandehurit i kanë kryer ndaj një viktime i cili në kohën e kryerjes së veprës penale ishte i mitur.

Të pandehurit G. dhe B.M., njëzëri i propozuan gjykatës që si rrethanë lehtësuese me rastin ta merr pranimin e fajësisë nga ana e tyre si shprehjen keqardhjes për rastin e ndodhur .

Me faktet e ofruara si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve, është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike, siç është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit G.M dhe B.M., qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale 184 par.3 nën par.3.1 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të të pandehurve dhe të njëjtit janë penalisht përgjegjës. Sa i parket fajësisë të pandehurit janë të vetëdijshëm për veprat e kryera dhe ato i kanë kryer me dashje.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese ne kuptim te nenit 69 dhe 70 të KPRK-së gjykata si rrethana posaçërisht lehtësuese për të pandehurit morri parasysh pranimin e fajësisë, po ashtu si rrethana lehtësuese morri pendimin e tyre për atë çfarë ka ndodh në ditën kritike , faktin se për të pandehurit është hera e parë që bijnë ndesh me ligjin , sjelljen korrekte gjatë procedurës, kurse si rrethana rënduese për të pandehurin morri parasysh faktin se veprat penale të pandehurit i kanë kryer ndaj viktimës së ndjeshme, fëmijës.

Sa i përket dënimit të shqiptuar të pandehurve, gjykata në rastin konkret, duke pas parasysh edhe pranimin e fajësisë nga ana e të njëjtëve, si rrethane posaçërisht lehtësuese, ka

aplikuar nenin 71 dhe 72 të KPRK-së dhe iu ka shqiptuar dënimin me gjobë konform nenit 72 par. 1 nën par. 1.7 të KPRK-së ku parashihet së “*nëse për veprën penale nuk është paraparë masa më e ulët e dënimit, atëherë mund të shqiptohet dënimi me gjobë në vend të dënimit me burgim*”, pasi që për veprën penale për të cilën akuzohet të pandehurit dënimi i paraparë është burgim deri në tre (3) vjet.

Sipas bindjes së gjyqtarit, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Gjyqtari i vetëm gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurve nga kryerja respektivisht përsëritja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale gjykata e morri konform nenit 449 par.1 dhe 2 nën par. 2.6, nenin 450, 452 paragrafi 1 të KPPRK-së,

Konform nenit 462 par. 2 të KPP-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike të dëmtuarën, gjykata e udhëzoi në kontest juridiko civil.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 369 të KPPRK-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**  
**Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal**  
**P.nr.775/21 me datë 14.12.2023**

**Bashkëpunëtore profesionale**

**Gjyqtare e vetme gjykuese**

---

**Gylaj Nepola**

---

**Ilda Cucović Sahatçiu**

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykatë.